VENDIM
Nr. 701, datë 9.9.2020

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 391, DATË 1.6.2011, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E STATUTIT TË SHOQËRISË 'NXITJA E BIZNESIT SOCIAL' SHA"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 8, të ligjit nr. 10376, datë 10.2.2011, "Për krijimin e shoqërisë 'Nxitja e biznesit social' sh.a.", dhe të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në statutin e shoqërisë "Nxitja e biznesit social" sh.a., që i bashkëlidhet vendimit nr. 391, datë 1.6.2011, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Kudo në statut, emërtimi "Këshill administrimi" zëvendësohet me "Këshill Mbikëqyrës".

b) Në pikën 3, të nenit 11, pas shkronjës "ç" shtohet shkronja "ç/1", me këtë përmbajtje:

"ç/1. Emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës;".

c) Neni 15 ndryshohet si më poshtë vijon:

"Neni 15
Këshilli Mbikëqyrës

Shoqëria mbikëqyret nga Këshilli Mbikëqyrës, i cili përbëhet nga 5 anëtarë, të cilët emërohen nga Asambleja e Përgjithshme.".

ç) Shkronja "b", e nenit 17, shfuqizohet.

d) Neni 18 ndryshohet si më poshtë vijon:

"Neni 18
Kompetencat e Këshillit Mbikëqyrës

a) Të japë direktiva për administratorin për zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë;

b) Të kontrollojë e të mbikëqyrë zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë nga administratori;

c) Të përgatisë me kërkesë të Asamblesë së Përgjithshme marrjen e masave që janë kompetencë e kësaj të fundit, t'i rekomandojë asaj vendime të vlefshme për t'u marrë, si dhe të zbatojë vendimet e Asamblesë së Përgjithshme;

ç) Të thërrasë mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, sa herë vlerësohet e nevojshme për interesat e shoqërisë;

d) Të kujdeset që shoqëria të respektojë ligjin dhe standardet e kontabilitetit;

dh) Të shqyrtojë e të kontrollojë librat kontabël, dokumentet dhe aktivet e shoqërisë;

e) Të sigurojë që pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecurisë së veprimtarisë, si dhe detyrimet e tjera të raportimit e të publikimit, të detyrueshme në bazë të ligjit apo statutit, të kryhen me saktësi nga administratori. Këto dokumente duhet të miratohen e të nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës për t'iu paraqitur Asamblesë së Përgjithshme, së bashku me një raport të Këshillit Mbikëqyrës për miratim dhe një përshkrim për mbikëqyrjen e menaxhimit gjatë vitit financiar;

ë) Të sigurojë që auditimi i librave dhe i regjistrimeve kontabël të kryhet të paktën një herë në vit nga një ekspert kontabël i autorizuar;

f) Të përcaktojë shpërblimin e administratorit;

g) Të vendosë krijimin e bashkëpunimeve tregtare afatgjata dhe propozimin e politikave për themelimin e shoqërive tregtare ose të grupeve të reja;

gj) Të kryejë veprimet e tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.".

dh) Neni 20 ndryshohet si më poshtë vijon:

"Neni 20

Administratori

1. Asambleja e Përgjithshme emëron një person fizik si administrator të shoqërisë, për një periudhë trevjeçare, si dhe merr vendim për revokimin e administratorit.

2. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës nuk mund të caktohen si administrator. Kufizime të tjera lidhur me emërimin e administratorit parashikohen në pikën 2, të nenit 158, të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar.".

e) Neni 21 ndryshohet si më poshtë vijon:

"Neni 21

Kompetencat e administratorit

Politikat tregtare të shoqërisë administrohen nga shoqëria dhe përfaqësohen nga administratori, i cili mund të ushtrojë të gjitha kompetencat e tij në përputhje me parashikimet e neneve 158, pikat 3 e 5, dhe 159, të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar.".

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe shoqëria "Nxitja e biznesit social" sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Erion Braçe